



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 12

Rrogozhinë, më 30.10.2024 ora 12 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja e shtyrë e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

(Kjo mbledhje ishte thirrur dhe planifikuar të zhvillohej me datë 29.10.2024, por për shkak të mos arritjes së kuoromit të nevojshëm, u shty për sot datë 30.10.2024).

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.4510.Prot datë 25.10.2024, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.11, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 26.09.2024.
- 3- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e Planit Social të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025-2028”.
- 6- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të mbetjeve Bashkia Rrogozhinë ”.
- 7 - Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e kërkesës së z. Haziz Jashar Kashari për ndihmë të menjëhershme financiare”.
- 8- Analizë mbi realizimin e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve për 9- mujorin e vitit 2024, si dhe informacion mbi ecurinë e punës për përgatitjen e Buxhetit të vitit 2025 nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e të Ardhurave.
- 9- Raport nga Administratori i Njësisë Administrative Sinaballaj mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Qershor - Gusht 2024.
- 10- Njohje dhe shqyrtim me draft Paketën Fiskale të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025.
- 11- Të ndryshme.



Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Merilin Saraçi, Isa Halili, Sokol Gosa, Mitat Daja, Gezime Met-hasani, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Enver Memolla, Fatmira Thartori, Erind Tosku, Mukades Gixhari.

Mungojnë :

Lije Dedej, Besnike Coraj, Saimir Cani, Altin Tosku, Renato Kalemi, Shpati Kolgega.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Mexhit Saliu - Administrator i Njësisë Administrative Sinaballaj
4. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
5. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
6. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
7. Ledian Hasani - Drejtor i mirëqënies dhe kujdesit social.
8. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
9. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
10. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
11. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
12. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
13. Sidorela Aliu - Specialiste IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, gjithsej 12- Këshilltarë. Këshilltarët z. Sokol Gosa dhe z. Erind Tosku i bashkohen në vijim mbledhjes duke e çuar në 14 numrin e të pranishmëve në sallë.



HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përhëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje : z. Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Merilin Saraçi, Isa Halili, Mitat Daja, Gezime Met-hasani, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Enver Memolla, Fatmira Thartori, Mukades Gixhari. Gjithsej jemi 12- Këshilltarë. -Lexojmë konfirmimin ligjor të ardhur për vendimet e këshillit bashkiak me karakter normativ të datës 26.09.2024 të ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Vendim nr .43, datë 26.09.2024 “Për miratimin e kërkesës Nr. 2107, për mbështetje financiare në lidhje me rehabilitimin e rezervuarit të Domen, fshati Domen, Njësia Administrative Kryeviidh”.

Konfirmohet në trajtën e kërkesës për fonde drejtuar AKMC-së referuar ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” si dhe VKM nr.53, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e kriterëve ... mbrojtjes civile” si dhe shkresës nr.1279/3.prot datë 12.08.2024 “Mbi kërkesën për akordim fondesh për rehabilitimin e digës Domen”.

Vendim nr.45, datë 26.09.2024 “Për miratimin e nismës së Aleancës së Grave Këshilltare, për mbështetjen financiare të projektit ‘Një rrugëtim drejt të ardhmes’ ”.

Nuk konfirmohet referuar ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar si dhe ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” pasi objekti i vendimit nuk ka referencë ligjore të përcaktuar si dhe as relacionin shpjegues dhe arsyetues të shoqëruar me dokumentacionin për vendimarrjen në fjalë. Përsa i përket fondit, sipas përcaktimit në vendim është i parashikuar në buxhetin vjetor të miratuar të bashkisë.

Vendim nr.47, datë 26.09.2024 “Për miratimin e fondit të akorduar për mbulimin e rritjes së nivelit të pagave”. Konfirmohet referuar ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.11789. prot datë 04.09.2024 “Dërgim fondi për rritjen e nivelit të pagave sipas kufirit minimal”

Vendim nr.48, datë 26.09.2024 datë 26.09.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të bashkisë Rrogozhinë”. Konfirmohet referuar ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, VKM-së nr.503, datë 01.08.2024 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe pagës bazë minimale në shkallë vendi” dhe VKM-së nr.326, datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”.

-Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës 26.09.2024 të



cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar janë si më poshtë :

Vendim nr .39. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2024 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6% .

Vendim nr .40. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2024 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr .41. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2024 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6% .

Vendim nr .42. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2024 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr .44. Për pranimin e dorëheqjes nga mandati i Këshilltarit të znj. Fatbardha Sina.

Vendim nr .46. Për miratimin e kërkesës së z. Xhelal Tosku për sponsorizimin e botimit të librit.

- Tani para se të kalojmë në rendin e ditës, kam një deklaratë ku kërkohet krijimi i një grupi të ri politik të këshilltarëve që kryesohen nga z. Mitat Daja.

Drejtuar kryetares së këshillit bashkiak Rrogozhinë znj. Mukades Gixhari.

Për dijeni : Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.

Të nderuar Këshilltarë ne jemi një grup këshilltarësh që nuk e ndjejmë veten pjesë e grupimeve aktuale në këshillin bashkiak. Për këtë arsye në harmoni të plotë dhe dakordësikemi vendosur të krijojmë një grup të veçantë këshilltarësh në këshillin bashkiak. Anëtarët e grupit shprehën vullnetin e tyre duke firmosur në këtë deklaratë. Grupi jonë do të emërtohet të bashkuar. Kryetari i grupit i propozuar nga ne është z. Mitat Daja. Shpresojmë që deklarata jonë të mos ketë kundërshti dhe të zbatohet menjëherë. Ju faleminderit për mirëkuptimin. Anëtarët e grupit janë që kanë firmosur : z. Mitat Daja, z. Isa Halili, z. Sokol Gosa dhe z. Saimir Cani. Po është në dy kopje. Të nderuar këshilltarë ju vumë në dijeni për krijimin e këtij grupi kryesuar nga z. Mitat Daja. Po znj. Silvana si kryetare e grupit të opozitës.

Silvana Aliu . Atëherë kryetare, krijimi i grupit është jashtë ligjit dhe nenit që keni bërë ju. Në radhë të parë formimi i grupit të këshilltarëve bëhet nga dy muaj këtë e këni shkelur po hajt se e vendosni e bëni kur të doni, ne jse. Personi që e ka kërkuar këtë nuk mund të jetë në atë grup përderisa i përket një grupimi fetar është shkelje dhe kjo nuk pranohet. Nëse grupi “debatikasit” apo qysh e kishin se nuk e mora vesh “Të bashkuar” që nuk janë ndjerë mirë . Në radhë të parë ato që kanë firmosur të japin largimin nuk mund ta ... dhe personi që kërkon të jetë kryetar i tyre nuk i pranohet për arsye se i përket një grupimi fetar dhe është imam në një Xhami.

Mitat Daja . Kërkon përgjigje nga unë ...?



Mukades Gixhari . E ka rregullorja znj. Silvana këto që thatë?

Mitat Daja . Unë nuk kam bërë kërkesë për propozim e kam bërë për dijëni ... përgjigjen e jep sekretari nëse është e ndaluar ligjërisht që një imam Xhamie osë një hoxhë të jetë përfaqësues në këshillin bashkiak duhet ta kishit ndaluar që në fillim këtë gjë dhe mos e bënit.

Silvana Aliu . Nuk po themi që është e ndaluar si anëtar këshilli por është e ndaluar për të formuar një grupim.

Mitat Daja . Unë jam imam Xhamie...

Silvana Aliu . E ke të ndaluar me rregullore...

Mitat DajaPërfaqësoj njerëzit që më kanë votuar si i pavarur grupi jonë përbëhet nga njerëz të cilët nuk janë pjesë unë jam i pavarur këto janë përfaqësues politik të partive tjera do na bashkëngjiten dhe tjerë ne jemi vetëm 4 nismëtarë që kemi firmosur për të krijuar grupin. Nëse është e jashtëligjshme, kjo nuk është për vendimarrje kjo është për dijëni nëse është e jashtëligjshme ne nuk duam të bëjmë gjëra të jashtëligjshme. Nëse unë jam i jahstëligjshëm si imam Xhamie që jam këtu, përfaqësoj një komunitet fetar është e jashtëligjshme mund të merrni masa prokurori, ku di unë prefekturë për përjashtim ska ndonjë problem.

Mitat Daja . Sigurisht grup këshilltarësh.

Isa Halili . S'është as grup politik ai pse është grup politik?

Ervis Shera . Ju keni deklaruar që jeni një grup fetar këtu?

Isa Halili . Jo, pikërisht këtë është duke të shpjeguar.

Mitat Daja . Absolutisht, pikërisht këtë jam duke thënë.

Silvana Aliu . Ju lutem mos ndërhy në këto pikat që keni ndërtuar po vetë. Nëse i përket një grupimi fetar nuk pranohet.

Ervis Shera . Nuk po deklaron atë ai.

Silvana Aliu . Kaq, aq më tepër që është imam Xhamie.



Mitat Daja . Mund të bëhet denoncim në prokurori edhe ky grup ose personi si puna ime që jam përfaqësues i komunitetit fetar mund të marri prokuroria masa për këtë punë meqë po nxis urrejtje fetare.

Indrit Dedej . Duhet të deklarojnë dorëheqjen ato tjerët njëherë. Duhet të bëjnë deklaramet ato tjerët nga grupet që kanë qenë.

Isa Halili . Fakti që janë bashkuar i bie që nuk janë tek grupi tjetër.

Mukades Gixhari . Nuk ja ka vënë në dijeni Saimiri?

Indrit Dedej . Thjesht deklaroni e shkoni ku të doni nuk po thotë njeri gjë.

Isa Halili . Nuk kemi qenë pjesë.

Indrit Dedej . Ke qenë se ti ke zëvendësuar Fredin.

Silvana Aliu . Ka qenë Fredi ke ardhur mbrapa.

Isa Halili . Ju po thoni ka qenë Fredi, unë jam duke ju thënë që në fund të muajit Maj, Fredi ka dhënë dorëheqjen nuk i përket këtij këshilli e para...

Silvana Aliu . Si ka mundësi gjatë kësaj kohe ti nuk e shprehe asnjëherë këtë por erdhe pikërisht tani? E para, e fundit të lutem kryetare përmbahuni pikave që keni bërë, një imam Xhamie nuk mund të jetë mos shkelni rregulloren që keni ndërtuar vetë.

Mitat Daja . Po mirë imami Xhamisë nuk lejohet me qenë në Këshill më çoni në prokurori.

Silvana Aliu . Nuk po them unë nuk lejohet të vihet në këshill, je zgjedhur kandidat i pavarur rri i pavarur.

Mitat Daja . Sigurisht i pavarur jam.

-Mbledhjes i bashkohet këshilltari z. Sokol Gosa në minutën e 7 të zhvillimit të saj.

Isa Halili . Atëherë edhe njëherë nuk është një punë këtu askush nga ne nuk mund të bëjë as gjykatësin as prokurorin gjithsecili nga ne këtu të majtë të djathtë me ose pa parti ka të drejtën e



vet legjitime t'i bashkohet një grupi politik dhe këtë nuk e ndal askush për ta bërë kryetar, sekretar apo ku ta di unë, e para e dyta...

Ervis Shera . Sekretari jo.

Isa HaliliJo e kisha në kontekstin e bisedës, diskursit në komunikim. Dhe ajo që është për t'u diskutuar tek kjo pjesa është fakti që gjithsecili nga ne këtu i lind e drejta e vet në një moment apo në një moment tjetër t'i bashkohet një grupimi që gjen veten e tij. Ne nuk jemi peng i askujt pavarësisht se mbi supe përfaqësojmë një parti politike ne komunikimin tonë sjelljen tonë vendimet tona, fatmirësisht ka njerëz që na gjykojnë që na votojnë apo që do të na votojnë. Kështu që këtu nuk jemi për të marrë mend askujt në qoftë se ajo gjëja ky grupim nuk lejohet po themi në rastin konkret që nuk lidhje fare se unë jam në dijeni të gjësë për çështjen e Mitatit ne mund të zgjedhim një kryetar tjetër por kjo nuk e zhbën faktin që ne kemi krijuar një grup që gjejmë veten me njëri tjetrin është kaq e thjeshtë historia dhe vazhdojmë me punimet që ka këshilli për ditën e sotme.

-Mbledhjes i bashkohet këshilltari z. Erind Tosku në minutën e 9 të zhvillimit të saj.

Mitat Daja . Edhe sa për shpjegim grupi është “Të bashkuar” dhe secili prej nesh ka identitetin e tij unë si i pavarur Isai oërfaësues i partisë Republikane, Sokoli si përfaqësues i një partie tjetër dhe Saimiri si përfaqësues i një partie tjetër dhe të tjerë që do na bashkangjiten janë përfaqësues të partive tjera ... secili prej nesh është në vendin e tij dhe do vazhdojë të jetë në vendin e tij. Kjo është dijeni pastaj ato që kanë ankesa...

Silvana Aliu . Po si s'paske turp, për atë Zot?! Nuk e gjete veten atje se s'të bën një cop drejtor dhe do vish të përçash këtej matanë?! Si s'ke turp? Ti je një imam përçarës ja po ta them unë ta dëgjojnë të gjithë. Je imam përçarës. Ti nuk duhet të ishe fare këtu.

Mitat Daja . Unë kërkoj nga këshilli bashkiak të mblidhet komisioni i etikës.

Mukades Gixhari . Atëherë z. Enver Memolla.

Mitat Daja . Të mblidhet komisioni i etikës dhe disiplinës dhe të vlerësojë fjalët e këshilltares.

Silvana Aliu . As se kam problem mblidheni ku të doni s'më bëhet vonë fare.

Mitat Daja . Jo, të mbaroj unë, kërkoj nga komisioni i disiplinës dhe etikës që të mblidhet dhe të



vlerësojë komunikimin e këshilltares, sepse ne nuk kemi ardhur këtu as që të ofendohemi, se shumë prej nesh disa herë janë ofenduar këtu dhe unë nuk kam ndërmend të merrem personalisht me njeri. Ka ligje ka rregulla, ju lutem mos e zgjas shumë sepse ...mblidh komisionin direkt pas kësaj mbledhjeje dhe nëse unë jam gabim, jam shprehur gabim kam folur gabim, të merret masa për mua dhe për atë që ka ofenduar të merren masa prap. Të lutem shumë dhe tani unë në këtë moment ta kërkoj dhe në cilësinë e kryetarit të grupit që ... shikoni dhe bëni.

Silvana Aliu . Nuk është grup mos e quaj fare grup se ai ... në momentin që anëtarët e atij grupi nuk kanë kërkuar dorëheqjen tek ne nuk është grup, dakord.

Enver Memolla . Thjesht më shumë për procedurë duke marrë shkas në nenin 30, për grupimin politik të këshilltarëve këtu janë cilësuar dhe pikat e të gjitha me radhë. Dhe kjo është një pjesë që nuk na takon ne por duke parë që dhe po vonon pjesën e mbledhjes gjëj të arsyeshme të ndërhyj duke pyetur dhe kryetaren e grupit që nëse ju keni të larguar nga grupi jeni vënë në diejti apo jo me shkresë zyrtare ju dhe kryetarja e këshillit. Sepse ta cakton ligji këshilltari që vendos të bëjë pjesë në një grup të ndryshëm nga ai ku është zgjedhur sipas listës zgjedhore duhet të ja komunikojë këtë vendim kryetarit të këshillit duke paraqitur edhe deklaratën me shkrim dhe të nënshkruar për pranimin dhe nga kryesuesi i grupit të ri.

Isa Halili . Sigurisht këtë deklaratë kemi bërë kemi firmosur që i përkasim këtij grupi.

Enver Memolla . Deklaratë që je larguar nga grupi i parë.

Isa Halili . Por nuk kam qenë pjesë e atij grupi, unë po flas për veten time.

Silvana Aliu . Ka firmosur Fredi, se s'ke qenë ti se nuk të votuan.

Isa Halili . Atëherë unë quhem Isa Halili nuk quhem Fredi e ka ai Avdiu.

Indrit Dedej . Të bëjnë dorëheqjen e të ikin ku të duan.

Isa Halili . Është një problem shumë i madh, ne po kërkohet nga ana jonë dorëheqja ne nuk kemi firmosur për të qenë në këtë grup, si do japim dorëheqjen?!

Mukades Gixhari . Ju nuk keni firmosur personalisht?

Isa Halili . As profesor Koli nuk ka firmosur, atëherë si mund të ikim ne nga një gjë që nuk kemi



qenë kurrë? Është fare e thjeshtë.

Indrit Dedej . Kryetare Koli është kryetar i zgjedhur nga grupi i djathtë është zgjedhur kryetar komisioni, ai Sokoli që thotë ai...

Mukades Gixhari . Profesorin e kemi këtu dhe flet dhe vetë. Tani të dëgjojmë pak z. Hekuran.

Hekuran Xhani . Tani me gjithë respektin se ne jemi të gjithë të barabartë këtu dhe respektoj liritë dhe dëshirat e çdo këshilltari për të vendosur tek cili grup do të jetë. Po ligji i vetëqeverisjes vendore neni 30 pika parë thotë grupet e këshilltarëve formohen dy muaj pas konstituimit të këshillit, jemi jashtë çdo afati ligjor për të ngritur merreni e lexojeni ligjin këtë se them unë e thotë ligji, që jemi jashtë afateve ligjore për të ngritur grupe. Unë thashë nuk jam kundër grupit sepse çdo njeri është i lirë të zgjedhi grupimin e vet por ligji e përcakton qartë unë tani po e lexoj.

Mitat Daja . Ka një gjë të jeni të sigurtë ju, e para kjo zgjidhet nga sekretari i këshillit sepse ai është jurist dhe ai e di këtë punë, e para. E dyta punës të jeni të sigurtë ju që edhe nëse ju e ndaloni këtë gjë kështu me ato ligjet që ju gërmoni nëpër ato vende andej, kjo nuk e ndalon shkëputjen tonë dhe veprimin tonë. Kështu që mos e vrisni mendjen fare për këtë punë dhe mos u lodhni fare sepse sa më shumë flisni aq më shumë na e shtoni dëshirën për të qenë në këtë lloj pozicioni edhe nuk do fitoni në fund për këtë gjë ju them. Unë këtë gjë e pres nga sekretari i këshillit konfirmimin nuk ka problem mos konfirmohet nuk është fare problem i imi. Problemin unë e ndjek në mënyrë të rregullt në mënyrë ligjore, ska lidhje fare nëse jam gabim prap ligji le të veprojë.

Hekuran Xhani . Mitat unë tani e lexova nuk kam asnjë...

Mitat Daja . Xha Hekri mund të futesh më thellë.

Hekuran Xhani . Më thellë dëgjo... a e di si është problemi Mitat ne këtu jemi përfaqësues të disa votuesve që na kanë sjellë edhe unë ndoshta nuk kam qejf edhe me ardhur këtu por unë kam pranuar që të marr një përgjegjësi përsipër dhe të vi t'i përfaqësoj...

Mitat Daja . Çfarë po të pengoj unë ty?

Hekuran Xhani . Ti ke të drejtën tënde morale dhe ligjore sepse je kandidat i pavarur dhe ke marrë votat tuaja. Personat politikë nuk kanë të drejtë të shmangen nga ato votues që i kanë sjellë



këtu. Unë përfaqësoj atë grup politik edhe vi këtu në emër të atyre me votën e tyre pa emër. Ti ke gjithë të drejtën tënde sepse votat tuaja ti i ke marrë si i pavarur por çdo gjë është e konstituar në ligj, neni 30 pika parë thotë sepse në çfarë po bëjmë po emërojmë dhe shkarkojmë ky që ke futur në grup ti para një muaji kishte firmosur dhe për shkarkimin tim, ky tani ka firmosur këtu është anëtar i këtij grupi ti e ke marr. Kupton ne nuk jemi këtu njerëz që vijmë nga rruga, jemi njerëz me intelekt dhe ne duhet të mbrojmë seriozitetin individual ashtu dhe përfaqësimin politik këtu. Thashë nuk kam gjë kundër por tani unë për vete nuk votoj për diçka që bie ndesh me ligjin.

Mitat Daja . Nuk të kërkova votim.

Hekuran Xhani . Këtu bie ndesh me ligjin.

Mitat Daja . Je këshilltar i vjetër ke qenë dhe sekretar. Atëherë unë nuk kërkova votim unë vura në dijeni nuk ka nevojë për votim kjo gjë.

Hekuran Xhani . Si do miratohet grupi, si miratohet grupi kështu kemi dëshirë ne. Për ti dhënë Ti kthej përgjigje mikut dhe vllait tim Isait, Fredi ishte anëtar i grupit opozitar në emër të përfaqësimit politik të opozitës u zgjodh nënkryetar i komisionit të bujqësisë ku jam pjesë dhe unë anëtar, tani ai thotë unë nuk jam...je politik o z. Isa ti përfaqëson një parti Republikane brenda koalicionit...po je opozitar pra.

Isa Halili . Po opozitar pse kush tha që ne do jemi me pushtetin?

Hekuran Xhani . Ti thua që unë nuk kam firmosur. Ka firmosur Fredi, Fredi se ti je zëvendësues këtu, ka pranuar përgjegjësinë e nënkryetarit të grupit të bujqësisë... Iku ai Agron Shehaj doli kandidat i pavarur kurse ti, të ikësh nga kjo parti se ti ke një elektorat, mbrapa të kanë votuar edhe tani ti i bastis gjithë ata votues edhe unë po iki me PS tani nuk ka moral politik është e pamoralshme.

Isa Halili . Edhe njëherë Hekuran nëse kjo ka moral apo nuk ka moral politik janë njerëzit që na gjykojnë as ti mua dhe as unë ty e para. E dyta nëse ai që ka qenë para meje këtu ka pas vendimet e veta kjo nuk do të thotë që unë të shkoj në linjën e tij se unë quhem Isa Besnik Halili dhe nuk jam Fred Avdiu e para. Të lutem tani mos i qani hallin kalorësit thotë populli se i varen këmbët se keni hallin e votuesve tanë. Votuesit tanë jam unë që merrem gjithësecili këtu mban përgjegjësitë e veta. Unë nuk e shoh veten time në një grup politik ku unë nuk shoh idealet që unë përfaqësoj është fare e thjeshtë dhe momentalisht ndodhem këtu ja ku është Mitati mund ta dëgjojnë edhe njerëzit, jam momentalisht në momentin e parë që unë shikoj që ata që unë dua



përpjekjet që unë kam, drejtimi që unë dua të kem në këtë vend për ata njerëz që na kanë votuar nuk e kam largohem menjëherë. Unë këtu jam Isa Halili kam dinjitetin tim të familjes time do marr vendime për veten time dhe askujt tjetër, është fare e thjeshtë.

Hekuran Xhani . Tani keqardhje të madhe për ty je dhe intelektual i ri...

Isa Halili . Nuk kam nevojë për mëshirën tënde...

Hekuran Xhani . Më lejo...

Isa Halili . Jo nuk të lejoj fare...

Hekuran Xhani . Vazhdo.

Isa Halili . Nuk të lejoj fare sepse nuk kam bërë veten për të më mëshiruar ti. Ti mëshiro veten tënde prezencën tënde unë jam Isa Halili kam vendimet e mia dhe nuk dua të paragjykoj askënd...

Hekuran Xhani . Nuk të paragjykoj...

Isa Halili . Por je duke e bërë një gjë të tillë. Nëse nuk kupton nocionin e paragjykimit nuk është problemi im është i joti. Paragjykovë në kuptimin e parë të fjalës, pra ti the kam një mikun tim këtu që ka ca njerëz që kanë votuar. Ata njerëz që kanë votuar jam unë që merrem me ata ti i përket një partie tjetër merru me njerëzit e tu, kaq e thjeshtë unë nuk po merrem me çfarë ke bërë ti në vendimarrjen tënde të jetës tënde po merrem me veten time dhe kjo nuk ndal askush vendimet që unë marr për veten time.

Hekuran Xhani . O z. Isa ti je një këshilltar politik, ke ardhur me vulën dhe propozimin me listën e dërguar pranë KZAZ nga z. Alfred Avdiu dhe z. Alfred Avdiu ishte i pari në listë dhe ka marrë pjesë në konstituimin e këshillit bashkiak në Rrogozhinë u bashkua me grupin opozitar pranoi dëshirën për të propozuar edhe anëtar i këshillit të qarkut si bashkëpunues i grupit unë nuk po them diçka jashtë realitetit. Pranoi dhe përgjegjësinë e nënkryetarit të komisionit të bujqësisë këtë po të them unë ty.

Isa Halili . Po dhe unë këto i di.

Hekuran Xhani . Tani ne kemi qenë bashkë ti mos më thuaj mua nuk kam qenë sepse ti ke qenë pjesë e opozitës ...



Isa Halili . Edhe jam pjesë e opozitës edhe do jem derisa të marr frymë pjesë e opozitës dhe nuk jam kundër askujt këtu që bëhet pjesë e opozitës. Edhe njëherë nëse nuk jeni të qartë jam i opozitës do jem derisa të marr frymë dhe duke qenë se jam tek grupi, ky grupi do bëjë opozitë më shumë se sa duhet ndoshta ne nuk jemi me pushtetin dhe koha do ta vërtetojë një gjë të tillë. E mbyllim këtë diskutim sepse unë e kuptoj që do marrim këtu vetë me njerëzit që na flasin në mënyrë personale gjithsecili nga ne këtu ka të drejtë të marri vendimet e veta.

Hekuran Xhani . Tani këta kanë bërë një kërkesë në bazën e ligjit nëse e përcakton ligji ata kanë të drejtë.

Mukades Gixhari . Atëherë duke parë pretendimet e dy palëve do të ja përcjellim komisionit të mandateve dhe presim konkluzionet prej tij, që ta mbyllim.

Mitat Daja . Edhe njëherë?

Mukades Gixhari . Duke parë pretendimet e dy palëve do të ja...

Mitat Daja . Nga e gjen këtë argumentim? Pse vërtetim mandatesh do bësh zysh më fal?

Mukades Gixhari . Jo verifikim mandatesh të bëhet diçka taman konform ligjit që ta bëjmë taman pa zhurmë ...

Mitat Daja . Çfarë lidhje kanë mandatet me këtë lloj arsytimi?

Isa Halili . Kryetare edhe njëherë se ndoshta jemi keqkuptuar ose ndoshta keni dëshirën për të na keqkuptuar.

Alime Hoxha . Kryetare të lutem kemi gjysëm ore që po merremi me një problem që nuk është as në rendin e ditës.

Isa Halili . Sikundër patëm 20 minuta që prisnim njerëzit të vinin në mbledhje.

Alime Hoxha . Të lutem, mos kur po flas unë kaq.

Isa Halili . Se nuk kam mbaruar unë që të flasësh ti...

Alime Hoxha . Jo mor zotëri se kam gjysëm ore që të dëgjoj ty.



Isa Halili . Do dëgjosh dhe një orë.

Alime Hoxha . Jo, të dëgjoj për ato që janë në rend dite, jo për ato që do ti.

Isa Halili . Nuk është rend i ditës kjo gjë?

Alime Hoxha . Jo nuk është.

Mukades Gixhari . Z. Isa znj. Alime ngriti dorën dhe mori leje.

Isa Halili . Po pra se duhet ta mbaroj unë njëherë retorikën e komunikimit pastaj ta marri tjetri...

Mukades Gixhari . Nuk ta ndërpre më fjalën.

Isa Halili . Po pra është ndërprerë fjala.

Mukades Gixhari . Jo, absolutisht.

Isa Halili . Po sepse unë kërkova të flisja dhe po thoja që për ta mbyllur diskutimin se ndoshta jemi bërë të bezdisshëm, ne nuk erdhëm këtu për t'u konfirmuar për këtë grup sepse nuk jemi për këtë gjë ne thjeshtë po ju vendosim në dijeni që ta dini dhe ta dëgjojnë ata njerëz që na dëgjojnë atje që nuk kërkojmë fare dhe kjo nuk ka fare për të shkuar tek mandatet çfarë mandatesh, ne jemi bashkuar në një grup që gjejmë veten gjithsecili kaq.

Mukades Gixhari . z. Isa të lutem ta dëgjojmë pak zonjën.

Alime Hoxha . I morëm vesh të gjitha ka mundësi ta mbyllësh tani, tani po flas Visi i ka grupet e këshilltarëve. Dy grupet i ke që në fillim?

Ervis Shera . Këtu ka diçka për të diskutuar por mbaroje.

Alime Hoxha . Janë grupet të formuara që në fillim?

Ervis Shera . Grupet e formuara që në mbledhjen e parë që është bërë në konstituim, grupi i djathtë ka funksionuar “de facto” faktikisht, se “de jure” nuk ka sjellë një shkresë dhe janë nënkuptuar Sokol Gosa, Fredi Avdiu, tre anëtarët e PD-së dhe 4...



Silvana Aliu . Pse ishin de facto në momentin kur ne zgjodhëm kryetar komisioni ...?

Ervis Shera . De facto sepse krijuat vepruat unison nuk doli Sokoli të thonte që nuk e dua kandidaturën e Hekrit nuk doli Fredi të thonte nuk e dua kandidaturën e Hekuranit kur u bë nënkryetar, ju dolët me dakordësi dhe nënkuptoheni që ju jeni një grup i tërë. Tani ka një ngërç këtu...

Indrit Dedej . Ai ka të drejtën e tij, të bëjë dorëheqje.

Alime Hoxha . Pikërisht këtë do thoja meqenëse këtu në ligj ju keni diçka që është e shkruar që çdo këshilltar ka të drejtë të largohet nga ai grup duhet t'i paraqesë kërkesën me shkrim kryetarit të grupit dhe në dijëni ...

Isa Halili . Po këtë e kemi bërë ne.

Alime Hoxha . Të lutem të flas dhe ta mbaroj.

Isa Halili . Po flet për një gjë që ne kemi gjysëm ore .

Alime Hoxha . Nuk e ke bërë.

Mukades Gixhari . Z. Isa, ka të drejtën ashtu siç folët ju do flasim të gjithë me radhë.

Isa Halili . Po thotë diçka që nuk ka lidhje me të vërtetën.

Mukades Gixhari . Le ta thotë do ta dëgjosh.

Isa Halili . Ok.

Alime Hoxha . Kam të drejtën si kryetare grupi kaq. Znj. Silvana i ke kërkesat e zotërinjve për tu larguar?

Silvana Aliu . Jo.

Isa Halili . Po nuk kemi qenë në atë grup Silvana.

Alime Hoxha . Zonja kryetare ju lutem juve ju ka ardhur njoftim, se kështu e thotë rregullorja?



Mukades Gixhari . Njoftimi është ky që unë ju lexova.

Alime Hoxha . Që këto japin dorëheqjen nga grupi?

Mukades Gixhari . Jo.

Alime Hoxha . Atëherë ne nuk jemi këtu për të gjykuar për mbledhjen e grupit këta le të mblidhen bashkë, le ta diskutojnë, le ta vendosin si të duan është e drejta e tyre le të krijojnë çfarëdo lloj grupi të duan dhe këtu ka dhe një gjë tjetër që në çdo grup nuk vendoset që në fillim kryetari por thotë : Çdo grup këshilltarësh në mbledhjen e tij të parë zgjedh kryesinë e tij kryetarin dhe një zëvendëskryetar, pra i keni po nga rregullorja. Pra nuk ka pse të vijë këtu tani, të diskutojmë ne kush është kryetari i grupit si është formuar grupi kjo është një punë e tyre. Ne jemi sot në një mbledhje këshilli për të diskutuar këto që kemi tek rendi i ditës.

Mitat Daja . Atëherë o Vis, o sekretar të të bëj një pyetje tani po diskutohet jo dorëheqja . Ligjërisht ekzistojnë deklaratat e këshilltarëve që janë bashkëngjitur grupacioneve politike? Ke deklarata të këshilltarëve? Leje marrëveshjen se edhe unë kam votuar për xha Hekrin, kam votuar dhe për zysh Desin, kam votuar dhe për Erindin si nënkryetar. Ekzistojnë deklarata të këtyre të firmosura që i bashkëngjiten se këto janë parti të tjera, që i bashkëngjiten një grupacioni të caktuar. Nëse ekziston më thuaj po dhe ti themi këtyre zotërinjve të japin dorëheqjen.

Isa Halili . Se unë nuk kam firmosur psh.

Alime Hoxha . Ti zotëri merrje ca informacione para se të vije.

Mitat Daja . A ka deklarata të tilla o sekretar?

Hekuran Xhani . Për procedurë kemi dal jashtë si grup opozite dhe kemi marrë bërë propozimet kemi ardhur këtu me propozimet tona bashkërisht si grup. Tani dëshirë për të ikur nuk mund ta ndalojë as Mitatin as Isain por puna është ne si Këshill të marrim diçka të miratojmë se nuk prish punë edhe ai grup të jetë për mua nuk prish asnjë punë.

Mitat Daja . Po çfarë problemi keni këtë nuk e kuptoj?

Hekuran Xhani . O Mitat problemi është që ne të marrim një vendim sepse do merret një vendim që të na qëndrojë në këmbë mos të na rrëzohet rrugës sepse unë thashë këtu lexova je intelektual vetë dhe thotë edhe konstituimi i këshillit edhe nënkryetarët e këshillit edhe



nënkryetarët e parlamentit zgjidhen në momentin që konstituohet parlamenti. Edhe kanë të drejtën të largohen nga pozicioni kur vdesin, japin dorëheqje kapen flagrancë dënohen nga gjykata penale. Edhe puna e këshilltarit është e dnërtuar mbi taë skemë.

Mitat Daja . I bëra një pyetje sekretarit të këshillit, a ka deklarata të anëtarëve që janë bashkëngjitur grupit? - S'ka. Çfarë problemi keni me këtë grupin ju se kuptoj?

Alime Hoxha . Tani do vazhdojmë mbledhjen apo do tërhiqemi ne?

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me rendin e ditës. Atëherë i deklaroni grupet në rrugë zyrtare.

Alime Hoxha . Vis është një çështje teknike që mund ta zgjidhësh më mbrapa. Tani ka mundësi të vazhdojmë me rendin e ditës?

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me rendin e ditës. Të nderuar këshilltarë, ju kam dërguar në grupin e ehatsapp projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.38 datë 27.12.2024 për buxhetin e bashkisë për vitin 2024”. Jeni dakord ta përfshijmë në rendin e ditës këtë projektvendim që ju erdhi? E hedhim në votim. Atëherë 11 pro, 3 kundër.

-Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, përfshirja në rendin e ditës të projektvendimit, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.38, datë 27.12.2024 për buxhetin e bashkisë për vitin 2024”.

Mukades Gixhari . Kemi dhe një projektvendim tjetër ...

Isa Halili . Kush ishin 11 pro?

Mukades Gixhari . Ja dy katër, gjashtë, tetë, dhjetë, njëmbëdhjetë.

Hekuran Xhani . Ngrejmë duart prap, unë atë që e votoj ...

Lulzim Hasa . Këto tre janë kundër.

Mukades Gixhari . z. Isa janë 11.

Isa Halili . Qartë.



Mukades Gixhari . Në rregull është dhe një projektvendim tjetër, “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkuar midis Bashkisë Rrogozhinë dhe ASHK-së”. Jeni dakord ta përfshijmë në rendin e ditës këtë projektvendim? E hedhim në votim. 11-vota pro, 3 kundër. Miratohet.

-Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, përfshirja në rendin e ditës e projektvendimit, “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkuar midis Bashkisë Rrogozhinë dhe ASHK-së”.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Miratimi i rendit të ditës. Jeni dakord për miratimin e rendit të ditës? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 14 (katërbëdhjetë) vota pro pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Miratim i procesverbalit Nr.11, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 26.09.2024. E hedhim në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 14 (katërbëdhjetë) vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 3, Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2024 nga fondi i Blllok - Ndhimës 6%”. Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani. Përshëndetje z. Ledian, fjala për ju.

Ledian Hasani . Kemi 16 familje që janë përfituese dhe fondi është 72 mijë lekë të reja për muajin Shtator 2024.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje rreth ndihmës 6 %. Pyetje? Atëherë e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 14 (katërbëdhjetë) vota pro pika 3 (tre) e rendit të ditës.

Vendim nr.49. Miratohet me 14-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.4402.Prot datë 18.10.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2024 nga fondi i Blllok – Ndhimës 6%”, si dhe Relacionin Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.4402/1.Prot datë 18.10.2024.



Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën tjetër. Pika 4, Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2024 nga fondi i pushtetit vendor”. Vazhdojmë po me z. Ledian.

Ledian Hasani . Në total janë 20 familje që janë përfituese dhe fondi është 77 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje rreth kësaj pike? E hedhim në votim...?

Silvana Aliu . Jo prit, duke qenë se kur bëre planin social na është bërë kërkesë nga individë të caktuar. Këto familje si e përfitojnë?

Ledian Hasani . Janë miratuar kriteret që para 4 vitesh, familje që janë në vështirësi ekonomike që janë me të ardhura të pamjaftueshme.

Silvana Aliu . Edhe kur është një person?

Ledian Hasani . Po një person është më keq akoma.

Silvana Aliu . Edhe kur është i ri dhe është në gjendje pune.

Ledian Hasani . Gjendje pune?! Nëse është i papunë ai .

Silvana Aliu . Se po i ra 10 herë për qark pazarit ashtu është, shihe nr.4.

Ledian Hasani . Për mua është i papunë ka sjell deklaratë.

Silvana Aliu . Papunë?! Në krahasim me familjet e tjera që janë familjarë dhe që janë taman në nevojë.

Ledian Hasani . Ka sjellë deklaratë që nuk ka të ardhura fare, që nuk punon me asnjë vend kështu që normalisht...

Silvana Aliu . Në atë moshë që është ai.

Ledian Hasani . Po ka dhe më të rinj, është dhe Aleks Mihal Xhavara.

Silvana Aliu . Aleks është student.



Ledian Hasani . Është student.

Silvana Aliu . Po ai numri 4 shiheni.

Ledian Hasani . Numri 4 i plotëson të gjithë kriteret gjithë dokumentacionin.

Indrit Dedej . Nëse i plotëson gjynah.

Ledian Hasani . 21 mijë lekë të vjetra.

Mukades Gixhari . Atëherë pyetje tjetër? E hedhim në votim. Vota pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 14 (katërmbëdhjetë) vota pro pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr.50. Miratohet me 14-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.4404.Prot datë 18.10.2024, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2024 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.4404/1.Prot datë 18.10.2024.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 5, Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e Planit Social të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025-2028”. Vazhdojmë po me drejtorin e mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Siç e keni dhe dokumentacionin përpara, bëme edhe dëgjues publikë, kaloi dhe në komisionet përkatëse, nëse është nevoja ta lexoj relacionin, nëse keni pyetje mund të pyesni për diçka.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje në lidhje me këtë pikë? Bëhet fjalë për planin social që u bë dëgjues publikë ditën e Hënë.

Indrit Dedej . Ne që ramë dakord jemi dakord.

Enver Memolla . Unë realisht u bashkova pak me vonesë kur ishte dëgjues publikë, po një kërkesë kam kryetare për sa i përket dëgjuesës. E kam shprehur dhe në komisionin e ekonomisë para dy ditësh, do kisha shumë dëshirë që këto dëgjues publikë për këto projekte sidomos që prekin shumë shtresa të mos bëhen tek salla e këshillit bashkiak. Të ketë një plan pune siç kemi



planin e këshillit bashkiak, të bëhet nëpër të 5 njësitë, të dëgjojen dhe atje afër se këtu 2 vetë ishin tjerët ishin...

Enver Memolla . Janë njoftuar të gjithë nëpërmjet rrjeteve sociale. Unë e kam për vendin dhe po ta them që nuk mund të bësh një dëgjese publike me shtresat vulnerabël kur një invalid nuk mund të vijë në sallë këshilli dhe të flasë. Programin se kam lexuar deri në fund duhet të informohemi si anëtar këshilli ky projekt deri ku arrin deri tek ndihma ekonomike apo deri tek ndërtesa? Se tek ndërtesa ka një problem shumë të madh bashkia nuk ka prona në pronësi të saj, këtë e dimë shumë mirë nga 2019 e mbrapa nuk kemi prona të bëjmë pallatin. Prandaj po them për sa i përket pjesës publike, mirë që jemi vonë se fillon në Korrik por mos të bëhen vetëm në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak. Unë kështu mendoj nuk e di sa janë kolegët dakord, kemi 5 njësi , 5 ditë java për 5 ditë mbyllet e gjithë Bashkia dhe të marrim dhe relacionet siç ishte dëgjesa kur ishte i ndjeri që shkuam atje.

Mukades Gixhari . Dje e diskutuam me këshilltarët që ishin këtu për dëgjuesën e radhës që do bëhet tek pallati i kulturës dhe nga të gjithë njësitë administrative.

Erind Tosku . Sa e kontrollueshme është kjo plan pune? Dmth çdo plan që kemi, sa e realizueshme është në tërësi është 100% e realizueshme.

Ledian Hasani . 100% e realizueshme nuk mund të jetë nuk ka shanse fare por ato janë parashikime, planifikime.

Erind Tosku . Sepse nëse nuk janë 100% të realizueshme një temë që ti, apo një plan që ti mund ta bësh dhe fiktivisht besoj dhe e quan të realizueshme, a ka tagër kjo që mund të ndodhi. Se tani kemi janë disa tematika këtu që mua më duken që lejnë hapësirë , po ke psh fletëpalosje sensibilizuese 200 copë.

Ledian Hasani . Po.

Erind Tosku . Kush ma kontrollon mua që ti do bësh 200 copë, ti bën 50, këtu e kisha më shumë.

Ledian Hasani . Të gjithë aktivitetet që janë parashikuar do kalojnë të gjithë me vendim të këshillit bashkiak, të gjithë aktivitetet do shoqërohen me foto për zbatim.

Erind Tosku . Shoqërohen me faturë?



Ledian Hasani . Normal nuk diskutohet fare.

Erind Tosku . Po këtë kisha.

Mukades Gixhari . Z. Indrit Dedej.

Ledian Hasani . Çdo aktivitet edhe 1 milion lekë të vjetra do kalojë në këshill bashkiak pastaj për zbatimin do merren personat përgjegjës për zbatimin

Indrit Dedej . Sa për t'i ashtu pak kolegut që ne kemi dhe të drejtën e kontrollit po të ngremë komisione nuk cedojmë nga kjo pjesë. Lusim që t'i realizojë 80, 90, 100 %.

Ledian Hasani . 100% është vetëm të gënjej këtu.

Indrit Dedej . Kurse për dëgjesat unë jam dhe bashkohem me Verin që dëgjesat e tjera do t'i bëjmë nëpër...

Isa Halili . Ajo që kuptova unë nga ajo që tha dhe Erindi është që të mos i shënojmë ca gjëra nëse ato nuk e kanë ... dmth më mirë ne do bëjmë këto tre gjëra po këto kemi mundësi shanse përpjekje për të bërë se sa të shënojmë ca gjëra aty edhe të themi pastaj që nuk mei mundësi t'i plotësojmë 100 % mos i shkruaj.

Ledian Hasani . Plani Social është për të tërhequr donatorë .

Isa Halili . Patjetër por në bazë të një konjunkte që ka arritshmëri në nivele mbi mesatare psh që një gjë aty është e paplanifikuar ose shanset janë shumë të pakta më mirë mos e quani atë gjë sepse gënjejmë veten .

Ledian Hasani . Po prap ne nuk është se do harxhojmë gjë edhe me ato që nuk na duken normale me bërë .

Isa Halili . Të harxhojmë energji me ato gjëra që kemi mundësi për të bërë mirë, që ajnë të arritshme për t'u bërë kaq e thjeshtë.

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër? E hedhim në votim? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.



-Miratohet me 14 (katërmbëdhjetë) vota pro pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr.51. Miratohet me 14-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.4347.Prot datë 16.10.2024 “Për miratimin e planit social të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025-2028”, si dhe Relacionin Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.4347/1.Prot datë 16.10.2024.

Ledian Hasani . Falemidnerit.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Ledian. Është pika 6-të...

Mitat Daja . Zysh në po vazhdojmë.

Mukades Gixhari . Kemi projektvendimet për të kaluar z. Mitat.

Mitat Daja . Ne do vazhdojmë.

Mukades Gixhari . Atëherë, Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të mbetjeve Bashkia Rrogozhinë”. Kemi drejtoreshën e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik znj. Marsida Thartori dhe drejtorin e financës z. Rezart Vogli.Tani sa mbetemi në. Z. Sokol edhe ju do vazhdoni?

Sokol GosaErdha vetëm për ndihmën ekonomike më shumë.

Mukades Gixhari . Po nuk kemi kuorum.

Enver Memolla . Kemi, kemi.

Mukades Gixhari . E kemi kuorumin ok atëherë vazhdojmë. Përshëndetje znj. Marsida dhe Rezart.

-Largohen nga mbledhja këshilltarët z. Mitat Daja, z. Sokol Gosa, z. Isa Halili në minutën e 40 të zhvillimit të mbledhjes së këshillit bashkiak.

Rezart Vogli . Atëherë administrata e bashkisë Rrogozhinë në bashkëpunim me projektin Bashkitë e Forta ka mundur studimin dhe realizimin e një projekti për planin e menaxhimit të mbetjeve të integruara në territorin e bashkisë Rrogozhinë me të dhënat që paraqet bashkia



Rrogozhinë të përcjella tek projekti kanë hartuar tre skenare se si do ishte më i mirë më i mundshëm trajtimi i mbetjeve në territorin e Rrogozhinës. Duke parë koston e mbulimit për këtë shërbim.

Indrit Dedej . Për mbetjet?

Rezart Vogli . Po flasim për mbetjet.

Indrit Dedej . Për mbetjet ne e lamë në komision që do ketë dëgjese publike.

Erind Tosku . Dakord shumë mirë e bëtë dhe unë dakord jam.

Enver Memolla . Edhe tek diskutimi i komisionit të ekonomisë gjëja që po cedon është dëgjese publike, flas si anëtar i komisionit të ekonomisë dhe duke parë dhe miratimin për planin e punës të këshillit bashkiak sot komisioni duhet t'i dorëzonte zyrtarisht nga dëgjesat publike propozimet përkatëse drejtorisë së taksave shërbimeve, financës për ndryshimet që duhet të bëhn në paketë fiskale sepse në këtë rast edhe po të bëjmë ne dëgjese publike afati kohor i shpalljes nga sot është 45 ditë që i bie 15 Dhjetori duke përfshirë edhe të Shtunat e të Dielat. Dhe nëse këtyre ja çon propozimet nga një dëgjese publike që mund të bëhet çfarë ndryshimesh do bëjmë kur projektbuxheti do jetë gati për t'u miratuar. Kjo gjë cedon dhe nga toleranca jonë në këshill bashkiak jam drejtuar disa herë për këtë pjesë, ndaj ja kërkova sekretarit planin e punës. Që nesër mos mblidhemi vetëm për ndihmat 6%, 3% se për ndihmën e plotë ka një VKM që e kalon vetë bashkia. Mos bëhemi pis atje jashtë nga pis dhe nga pisat, nëse jemi anëtar të këshillit bashkiak dhe jemi me të drejtë vote këtu, kemi dhe një logo mbrapa është shumë e rëndë.

Mukades Gixhari . Shumë e vërtetë.

Enver Memolla . Është e vërtetë se është hera e pestë rresht që ngre këtë problematikë dhe realisht unë kam folur gjatë për këtë pjesë... por do flas tek plani i punës i këshillit bashkiak unë këtu e kam. Realisht kryetari i komisionit sot dhe nënkryetari nuk kanë çfarë thonë sepse nuk ka dëgjese publike nuk ka asnjë komunikim përveç dy fakteve që kam sjellë unë që janë miratimi gabim i tarifës së vjetshme që me vendim këshilli u anulua dhe tjetra rikonstruksioni dhe ajo paketë është po e njëjta në diskutim. Dhe sot ne duhet të përplasemi të dy opinionet të dy opsionet apo të tre bashkë me Bashkitë e Forta për të arritur edhe tek mbetjet. Të flasim kryetarët e komisioneve unë kaq kisha.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Enver. Ndonjë pyetje tjetër?



Alime Hoxha . I tha Veri çfarë do themi tjetër. Dëgjuesën publike nuk kemi kohë.

Erind Tosku . Nga tre skenaret që ju keni kush janë më të realizueshëm?

Rezart Vogli . Plani i menaxhimit nuk ka për qëllim ndryshim buxheti, ka për qëllim ashtu si plani social që dhe për planin e menaxhimit të mbetjeve të integruara bashkia të ketë një plan të miratuar.

Erind Tosku . Po pse mos e ketë ndryshimin e buxhetit dhe mundësinë e ndryshimit të taksave?

Marsida Thartori . Ky plan përshin 5 vitet e ardhshme...

Hekuran Xhani . Ky është një projekt ide që kërkohet nga “Bashkitë e Forta”?

Erind Tosku . Kur është një projektide pse ka ceduar dëgjesa publike?

Alime Hoxha . Ja një diçka sepse. Për planin vendor të menaxhimit të mbetjeve faktikisht Bashkia e ka bërë një dëgjese publike, ketu tek salla e Këshillit është bërë paranjë muaji dy muajsh më duket ka qenë dhe...

Marsida Thartori . 18 Korrik.

Alime Hoxha . Kanë qenë dhe Bashkitë e Forta dhe ishin po tre skenaret dhe ishte një propozim për rritjen e tarifës së pastrimit duket sa ishte nga 12 mijë lekë të vjetra një propozim që ishte këtu ishte tek 15 mijë lekë të vjetra .

Marsida Thartori . Nga 12 në 15 që të kemi një rritje graduale.

Alime Hoxha . Dhe ishte dhe 18 një variant?

Marsida Thartori . Ishte dhe 18, 25 dhe 35 që ishte me mbulim, 35 përfshin mbulimin deri 60%.

Alime Hoxha . Sepse ne aktualisht mbulonim vetëm 13%?

Marsida Thartori . 13% të kostos.



Alime Hoxha . Pra ne me të ardhurat që mbledhim nga Bashkia mbulonim vetëm 13 % të kostos së pastrimit të qytetit, gjithë bashkisë me atë 12 lekë. Tani ne lamë që do ta rrisnim diku tek më duket menduam për 18 mijë lekë të vjetra që thamë rritje me 50 % pastaj ...

Rezart Vogli . Ajo është diçka për t'u diskutuar tek paketa fiskale, gjatë diskutimit lidhur me këtë problematikë në territorin e bashkisë Rrogozhinë për qytetin kosto ose më saktë tarifa e shërbimit për pastrimin e familjeve është 1200 lekë të reja në vit që i bie diku tek 100 lekë të reja në muaj. Dhe gjatë diskutimit lindi nevoja që është një kosto shumë e ulët për mbulimin e kontratës së shërbimit që mbulon 80 % nga tarifa e grumbullimit për këtë shërbim mbulon 80% të kostos së kontratës. Por tarifat dhe taksat do të diskutohen gjatë paketës fiskale, ky projektvendim ka për qëllim miratimin e një plani strategjik për mbetjet e integruara për grumbullimin depozitimin...

Marsida Thartori . Plani parashikon që një skenar i planit ishte që ligji parashikon që të bëhet ndarja në burim në projekt pilot edhe ky projekt pilot shtrihet qendër Rrogozhinë, qendër Gosë, qendër Lekaj bëhet ndarja në burim. Qeveria ka marrë një nismë që të krijojë një stacion transferimi në Peqin, kjo do të sjelli uljen e kostos së karburanteve transportit të mbetjeve. Stacioni i transferimit në Peqin do të bëjë ndarjen e mbetjeve, mbetjet që mund të jenë për riciklim do të qëndrojnë në zinxhirin e riciklimit që do të thotë do të uli koston prap të mbetjeve që nuk do shkojnë më për ekzekutim nga inceneratori dhe pjesa tjetër do shkojë për ekzekutim...

Erind Tosku . Po skenari në qoftë se e Peqinit prishet?

Marsida Thartori . E parashikon ligji dmth...

Erind Tosku . E kupton çfarë po them skenari që në qoftë se një qendër nuk do ndërtohet. Ndërtohet por del jashtë funksioni jashtë pune, rritet kosto dhe do e çosh prap po e zejmë në Elbasan.

Marsida Thartori . Po janë dy skenarë nëse nuk ndërtohet stacioni i transferimit do shkojë në incenerator dhe është skenari që do ndërtohet stacioni i transferimit do bëhet ndarja në burim dhe sipas ndarjes në burim këto mbetje do shkojnë kush është për riciklim do qëndrojnë në zinxhir kush është për riciklim do shkojë ...

Alime Hoxha . Por Bashkia Rrogozhinë do ndjekë skenarin e dytë,ndarja në burim.

Marsida Thartori . Po, ndarja në burim.



Alime Hoxha . Po a është e realizueshme kjo ndarja në burim?

Marsida Thartori . Po sipas VKM përfillet që këtë duhet ta bëjnë gjithë bashkitë...

Indrit Dedej . Në dijeninë time nga disa lëvizje të vogla në popull kanë shprehur pakënaqësi sepse firma merr aq sa mbulon dhe territori nuk mbulohet me shërbim nga firma se ne flasim firma ka një kontratë edhe ka ankesa nga banorët aty ku ka dhe asfalt nuk ka shërbim. Edhe në momentin që ne nuk kemi arritur t'i çojmë shërbim, se di se çfarë... se me letra jemi në rregull ne kurse ndarja në burim unë shoh që qyteti bashkia më e madhe e dyta në Shqipëri nuk e bën ndarjen në burim.

Marsida Thartori . Është detyrim ligjor që ne ta bëjmë.

Indrit Dedej . Detyrim por ta bëjnë njëherë ato bashkitë e fuqishme të mëdha pastaj e bëjmë ne të voglat se me letra...

Marsida Thartori . E kemi detyrim ligjor që ne duhet ta bëjmë.

Indrit Dedej . E ke detyrim ligjor që ti të mbulosh territorin me kosha plehrash dhe deri tani ti nuk ke realizuar asnjë lloj detyrimi, në moment që ti nuk ke detyrim ne nuk jemi dakord që të kalojmë asgjë nga ajo.

Marsida Thartori . Ok dhe ne prandaj e kemi ndarë dhe me zona...

Indrit Dedej . Se ne mbrojmë interesin e qytetarëve.

Marsida ThartoriTarifimi është sipas zonave sipas mbulimit, zona A ...

Indrit Dedej . Ti je në rregull me letra ne nuk jemi në rregull në praktikë.

Silvana Aliu . Ne po të themi që deri tani shërbimi nuk është bërë.

Marsida Thartori . Dhe unë po të them që zona C është pa mbulim shërbimi e ka tarifën zero. Zona B e ka 500 lekë...

Silvana Aliu . Aty ku ka tarifë pastroni shumë?



Marsida Thartori . Qyteti pastrohet.

Indrit Dedej . Është qyteti brenda që nuk mbulohet.

Marsida Thartori . Qyteti brenda 1 mijë lekë në muaj e paguan.

Indrit Dedej . Por jo zero paguan taksën ai.

Silvana Aliu . Meqë qenka tarifë e ulët për qytetin dmth mos pastrohet?!

Indrit Dedej . Flas për qytetin nuk flas për fshatrat se atje nuk shkon mushka jo të shkojë njeriu apo makina nuk kanë rrugë fare fshatrat. Bashkia nuk e kontrollon fare territorin se nuk shkon mushka.

Alime Hoxha . Ne nuk po flasim për tarifën por po flasim për skenarin.

Rezart Vogli . Nuk po flasim për kontratën e shërbimeve.

Alime Hoxha . Po pra e lamë atë ju po thoni që bashkia do të ndjekë skenarin e dytë dhe jeni tek ndarja e mbetjeve në burim. Tani kjo është pothuajse e pamundur sepse kush do ta kontrollojë? Unë nuk dua t'i hedh i hedh ashtu siç i kam të gjitha.

Marsida Thartori . Do bëhet një fushatë ndërgjegjësimi.

Alime Hoxha . E lëmë fushatën e ndërgjegjësimit se ne e dimë shumë mirë sa ndërgjegjësohen duam kohë ne të ndërgjegjësohemi për atë pjesë ne nuk po ndërgjegjësohemi t'i çojmë atje tek vendi që është ku e kemi një kosh dhe jo të ndërgjegjësohemi kaq kollaj për t'i ndarë e para. E dyta të duhet dhe infrastruktura se ti duhet ti kesh koshat të ndara sipas atyre që do kesh mbetjet. Pra një person në një familje nuk i ndan dot 4 qese ato mbeturinat sado që të mundohet për mua kjo është diçka që...

Marsida Thartori . Por është kosto më e lartë për ne pastaj sepse bashkimi europian parashikon...

Alime Hoxha . Nuk e di sa e keni marrë parasysh ju këtë pjesë që do ta realizoni dot apo jo për mua kjo duket pak e parealizueshme.



Marsida Thartori . Bashkimi europian e ka detyrim ligjor që mbetjet duhet të diferencohen dhe ne duhet t'i diferencojmë dhe duhet të bëjmë këtë gjë. Duhet të fillojë ndërgjegjësimi tek vetja, do fillojë ndërgjegjësimi nëpër shkolla, fëmijët janë e ardhmja ndoshta nuk do ta bëjë pensionisti sot por ai fëmijë duhet të fillojë të edukohet sot që nesër kur të bëhet familje .

Alime Hoxha . Ne po flasim çfarë do ndodhi sot.

Erind Tosku . Unë e kam më shumë tek infrastruktura në radhë të parë që tek lagjja që kur do vendosësh koshat iku kjo pjesë, tek pallatet e njëjta gjë po tek zonat që janë rurale sipër stacionit nëse nuk ndodh merr bashkia gjobë në qoftë se tek koshi i plastikës ka të gjitha llojet e mbetjeve?

Marsida Thartori . Për aq kohë sa do jetë projekt pilot nuk do ketë se është pilot do testohet në qendra urbane. Në Rrogozhinë qendër qytet, Gosë qendër qytet, Lekaj qendër qytet që pritet që njerezit do të jenë më të ndërgjegjshëm që shërbimi do jetë më i mirë dhe është pilot.

Erind Tosku . Bashkia e ka të ngritur infrastrukturën për të bërë këtë lloj ndryshimi dhe e dyta ka kosto ekstra në qoftë se ne marrim gjobë? Sepse projekti pilot mund të jetë dhe 6 muaj.

Marsida Thartori . Jo kjo flet 5 vite, që ne nuk themi ta bëjmë sot për nesër.

Erind Tosku . I bie nëse projekti pilot dështon ne do vazhdojmë po me rregullin që kemi qenë.

Hekuran Xhani . Tani kosto financat e bashkisë ...

Rezart Vogli . Nuk po flasim për kosto, po flasim për planin e menaxhimit të mbetjeve.

Hekuran Xhani . Një minutë dhe menaxhimi është projekti sot nesër ai do bëhet realitet ai plan.

Rezart Vogli . Nuk ka si bëhet realitet se në asnjë moment këtu nuk thuhet për diçka që do bëhet realitet.

Marsida Thartori . Nuk ka një datë kur do bëhet realitet ajo përfshin 5 vite.

Rezart Vogli . Është një plan i bashkisë Rrogozhinë për mënyrën se si do grumbullohen se si do transportohen ...

Hekuran Xhani . Atëherë ne kemi gjysëm ore që po merremi me këtë çështje.



Rezart Vogli . Unë në asnjë moment nuk po diskutoj kontratën e shërbimit.

Indrit Dedej . Jo me kontratën nuk ke punë me kontratën e ke aq shërbim bën.

Hekuran Xhani . Përse e zgjasim atëherë? Ne idetë dhe projektet europiane i kemi shumë qejf sepse ne në vitin 90 xhaji ishte student dhe thoja e duam Shqipërinë si Europa, faktikisht ne jemi shumë larg kësaj kulture megjithatë ne si projektide jemi të gatshëm ta miratojmë dhe mos harxhojmë kohën të kalojmë tek pikat e...

Rezart Vogli . Po s'është gjë tjetër ky është plan.

Silvana Aliu . Edhe tek shkolla jonë kanë ardhur tre projekte pilot asnjë nuk është bërë.

Hekuran Xhani . Tani kaq kulturë kemi ne atë e tha dhe...

Silvana Aliu . Nuk e kanë menaxhuar, jo se kaq kulturë kemi nuk e kanë menaxhuar.

Hekuran Xhani . Silvana ne shqip nuk i hedhim tek koshi se përtojmë me i zbritur nga makina por e bëjmë nga makina i hedhim në tokë. Kjo është kultura tani ne duhet të jemi koshientë.

Indrit Dedej . O lal Hekri të them një gjë të bukur fare unë ty, unë isha dje parkova makinën tek kopshti i fëmijëve edhe polici shkretë ishte në këmbë. Unë sa do dilja më erdhën tre makina me tangërllek dhe i thashë policit po ti?- Unë i shkreti tha as bllok nuk kam, as rrogë nuk kam fare...

Rezart Vogli . Nuk përfshihen policët tek plani i mbetjeve.

Indrit Dedej . Ky është plani jot pra se edukata këtu duhet të vijë,

Rezart Vogli . Ky plani im është bërë në bashkëpunim me Bashkitë e Forta.

Indrit Dedej . Ai plani jot nuk pi ujë shoku Bashkitë e Forta tujat janë falso.

Rezart Vogli . Pse falso?

Indrit Dedej . Ta them unë që janë falso, ti nuk ndërgjegjëson dot qytetarët jo do më ndërgjegjësosh mua si të ndash koshin e plehrave. Ti nuk menaxhon dot qendrën dy makina je afër bashkisë.



Hekuran Xhani . Kosto a ka Bashkia?

Rezart Vogli . Jo.

Mukades Gixhari . Atëherë e hedhim në votim. znj. Fatmira Thartori.

Fatmira Thartori . Atëherë si ide si projekt që financohet nga Ministria administrohet nga bashkia por financohet nga shteti është ide e mirë.

Indrit Dedej . Hiç financim nga shteti.

Fatmira Thartori . Është një pjesë e financimit nga shteti por ...

Rezart Vogli . Asistencë e plotë është nga projekti Bashki të forta. Asistim moment pas momenti muaj pas muaji vit pas viti është nga ana e tyre. Ne jemi para faktit që do miratojmë një plan për trajtimin e mbetjeve të bashkisë Rrogozhinë që deri dje, deri sot dhe për disa vite kemi kontratë me një firmë nesër pasnesër kur të mbarojë kontrata ose ndoshta mund të jemi të aftë ta bëjmë ne si bashki .

Fatmira Thartori . Si projekt ide si plan pilot mua më pëlqen...

Rezart Vogli . Në çdo moment bashkive i kërkohen plane projekte për të ardhur fonde, ne tani po e mundësojmë siç mundësuam planin social edhe planin e mbetjeve që nesër pasnesër nëse do jetë e mundur të kërkojmë fonde lart.

Fatmira Thartori . Ama për skenaret nuk jam dakord për planin pilot jam.

Indrit Dedej . Këto janë plane që janë të vdekura kanë 20 vjet, plan bashkitë e forta s'bëhet asgjë është kot më mirë hiç.

Marsida Thartori . Plani është njësoj siç e parashikon plani kombëtar i menaxhimit të mbetjeve dmth është bërë një plan kombëtar i menaxhimit të mbetjeve dhe çdo bashki do ta qasi sipas...

Enver Memolla . Deri diku si pjesë e komisionit të menaxhimit të mbetjeve kam qenë edhe unë si përfaqësues i këshillit kam ardhur nga Marsi, i di disa gjëra disa kritere. Ajo çka është kjo pjesë është që po kërkohet një plan menaxhim i ri i mbetjeve duke parë që e kaluara na ka lënë këtu ku jemi ne mbrapa qoftë nga idetë mentaliteti jonë por dhe pjesa tjetër. Ajo cka unë kam një



pyetje të drejtpërdrejtë për drejtorin. Ky plan menaxhim është efektiv për të rregulluar për të menaxhuar sa më mirë mbetjet dhe për të zgjeruar hapësirën e pastrimit nga kompania përkatëse për këtë pjesë? A ka efektivitet për zgjerimin e shërbimit?

Rezart Vogli . Sipas studimit po.

Enver Memolla . Se mesa di unë janë çuar të dhënat... studimi është bazuar në dy gjëra çfarë ka çuar drejtoria e shërbimeve tek Bashkitë e Forta dhe është përplasur me idenë e bashkive të forta dhe ka dalë një konkluzion. Atëherë nuk e kuptoj ky skenar deri ku arrin?

Marsida Thartori . Plani parashikon që për zonën A të mbulohet shërbimi 100% dhe për zonën B 90%.

Enver Memolla . Zona B, kë përfaqëson?

Marsida Thartori . Zona B është zona më rurale që aktualisht është me shërbim 70 %. Dhe ona A është zona që është me shërbim 90 %.

Enver Memolla . Shërbim 70 % është tek lagjja ime sot brenda vijës së verdhë.

Marsida Thartori . Sipas skenareve plani parasikon rritjen e shërbimit zona A 100% dhe ona B në 90 %.

Enver Memolla . Në bazë të skenarit do ju vijë dhe kontratë tjetër do ndryshoni kontratën, vitin tjetër. Normalisht që po se do zgjeroni shërbimin dhe një e dyta skenari me kontratë nuk e di si është por po them sot 70 % nuk e ka zona ime lagjja ime. Një herë në tre ditë një herë në dy ditë njëherë digjen njëherë piquen problemi është këtu që këtu nuk ka asnjë buxhet asgjë thjeshtë duhet të kalojë si plan. Por nga ju si bashki po kërkojmë këtë pjesë, trysninë tuja se ju jeni menaxhuesit dhe përplasja e faktit me qytetarin ...

Marsida Thartori . Plani ka dy qëllime rritjen e shërbimit uljen e kostos. Bashkia parashikon rritjen e shërbimit zona A 100%, zona B 90%, uljen e kostos me stacionin e transferimit që nuk do jetë më 35 km distanca për mbetjet do jetë 10. Dhe nuk do shkojnë më të gjitha mbetjet si mbetje të thata për në incenerator por mbetje që do rrinë në ciklin e mbyllur do riciklohen dhe do ulët kosto e bashkisë, dmth këto janë dy qëllimet.

Enver Memolla . Duke parë që në kontrollin trysninë tuaj me kontraktorin të jeni akoma ju më



kërkues sepse thashë sot para bashkisë ishte pa pastruar, në orën 8 pa 5.

Silvana Aliu . Më fal, a kalon tek stacioni i trenit ti?

Enver Memolla . Aty jetoj.

Silvana Aliu . Po pra, sa herë pastrohet aty?

Enver Memolla . Ta thashë 70 % digjet.

Hekuran Xhani . Sot çdo qytetar i bashkisë Rrogozhinë paguan një taksë për pastrim, tarifë. Ky projekt ide synon rritjen apo uljen e taksës së qytetarëve? Në rast se preket qytetari...

Enver Memolla . Synon uljen e kostos mesa dëgjova.

Marsida Thartori . Uljen e kostos së karburantit të bashkisë.

Enver Memolla . Nëse ulet kostoja ulet dhe taksa.

Rezart Vogli . Atëherë në momentin që ulet kostoja, bashkia kursen disa fonde për disa punë të tjera. Qëllimi i planit është mirëmenaxhim, bashkia të mirëmenaxhojë sa më mirë...

Hekuran Xhani . Nuk ka të bëjë me rritjen e tarifës së pastrimit ?

Marsida Thartori . Tarifat janë tek paketa fiskale, që mund të rriten me ndryshimin e paketës. Por ne aktualisht mbulojmë 13% të kostos do të thotë 87% e kostos mbulohen vijnë nga të ardhurat e tjera.

Rezart Vogli . Është paketa fiskale ajo që e bën ndryshimin.

Marsida Thartori . Dhe nëse ne rrisim tarifën do të thotë që ne sërish do rrisim mbulimin nuk do të thotë që ne do të na teprojnë të ardhura, ne po kërkojmë mbulimin e rritjes së tarifës.

Indrit Dedej . Do kalojë në dëgjese rriten çmimet.

Marsida Thartori . Jo çmimet rriten në paketë, çmimet nuk rriten tek kjo. Mos i ngatërrojmë gjërat tarifa e pastrimit parashikohet në paketë fiskale jo në plan. Në plan ti bën një analizë



kostoje, kjo nuk përfshin rritje përfshin analizë kostoje. Këtu është analizë kostoje të janë dhënë 4 opsione pas çdo tarife. Zysha që ta sqarojmë rritja e tarifës do diskutohet tek paketa fiskale.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim. Tarifën e keni tek paketa fiskale.

Indrit Dedej . Nuk do Fatmira.

Hekuran Xhani . Fatmira do e miratojmë apo jo?

Mukades Gixhari . Paketën Fiskale e kemi tek dëgjesa publike.

Marsida Thartori . Tarifën do ta diskutojmë tek paketa.

Alime Hoxha . Bëja pyetjen çfarë problemi ka që ta sqarojë.

Mukades Gixhari . Po znj. Fatmira.

Fatmira Thartori . Atëherë unë jam dakord që të kalojë projekti...

Indrit Dedej . Për hajër i qoftë.

Fatmira Thartori . Jam dakord me projektin por në qoftë se nuk miratohet projekti nuk bëhet projekti këto mbetje mbeten atje në Gosë Rrogozhinë ?

Hekuran Xhani . Nuk ka lidhje kjo. Po më ngel Luzi mua jam dakord unë të më ngelë Luzi!

Mukades Gixhari . E hedhim në votim. Vota pro?

Fatmira Thartori . Jeni 11 me gjithë Fatmirën po nuk e ngriti Fatmira ti je 10.

Lulzim Hasa . Pse do të lusim ty, asgjë po nuk e votove.

Hekuran Xhani . E çojmë dhe një herë këtë në dëgjesë bashkë edhe e mbyllim kështu.

Alime Hoxha . Kjo është për të përcaktuar një strategji që do të përdori bashkia kaq nuk ka lidhje kjo për të shkuar tek dëgjesa publike se nuk është tarifa që miratohet. Tani unë e ngrita atë



problem meqë ju thoni kemi zgjedhur skenarin e dytë. A është e menaxhueshme? Unë këtu e kam dilemën time a është e menaxhueshme që kjo të bëhet ndarja në burim?

Hekuran Xhani . Po kur do bëhet kjo në 2030? Fatmira kjo bëhet pas viteve 30.

Indrit Dedej . Fatmira tek paketa fiskale ne i ulim çmimet kaq.

Fatmira Thartori . E miratojmë muajin tjetër e kalojmë muajin tjetër.

Mukades Gixhari . Atëherë ta hedhim apo ta shtyjmë për mbledhjen e radhës. E hedhim në votim. Vota pro. 10 pro, 1 kundër. Nuk miratohet.

-Nuk miratohet me 10 (dhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 1 (një) abstenim, pika 6-të e rendit të ditës, “Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të mbetjeve Bashkia Rrogozhinë ”.

Ervis Shera . Fatmira je kundër?

Fatmira Thartori . Jo nuk jam kundër, abstenim.

Lulzim Hasa . Abstenimi kundër është nuk miratohet, abstenimi ka vlerën e kundër se nuk miratohet, abstenimi ka vlerën e kundër se nuk miratohet, ç’lidhje ka abstenimi.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën tjetër, miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e kërkesës së z. Haziz Jashar Kashari për ndihmë të menjëhershme financiare”. Drejtori i financës z. Rezart Vogli.

Enver Memolla . Kjo kaloi radhën që kaloi.

Mukades Gixhari . Atëherë e hedhim në votim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, pika 7 e rendit të ditës.

Vendim nr.52. Miratohet me 11-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.4494.Prot datë 24.10.2024 “Për miratimin e kërkesës së z. Haziz Jashar Kashari për ndihmë të menjëhershme financiare”, si dhe Relacionin Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.4494/1.Prot datë 24.10.2024.



Lulzim Hasa . Jo, unë abstenoj.

Mukades Gixhari . E the me vonesë.

Hekuran Xhani . E the me vonesë.

Lulzim Hasa . Ngrejta dorën para.

Indrit Dedej . A e ngrejte ti.

Mukades Gixhari . Tani kalojmë dy projektvendimet e tjera që kemi pastaj kalojmë tek pika 8. Kemi dy projektvendimet që i dhamë në ehatsapp, që i thamë në fillim të mbledhjes.

Alime Hoxha . Pastaj do kalojmë tek pika 8?!

Enver Memolla . Pse zysha?

Mukades Gixhari . T'i marrim me radhë? Ok në rregull. Atëherë, analizë mbi realizimin e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve për 9- mujorin e vitit 2024, si dhe informacion mbi ecurinë e punës për përgatitjen e Buxhetit të vitit 2025 nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e të Ardhurave. Drejtoresha e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik znj. Marsida Thartori. Marsida përshëndetje dhe njëherë, ta dëgjojmë drejtoreshën.

Marsida Thartori . Ju kemi dërguar të ardhurat e 9-të mujorit...

Lulzim Hasa . Këto ikën të gjithë...

Enver Memolla . S'ke kuorum nuk e vazhdon dot.

Mukades Gixhari . Jo jo nuk është projektvendim është diskutim, sa të pinë një cigare ato.

Lulzim Hasa . Ver lëre të vazhdojë nuk do rrimë gjithë natën këtu.

Marsida Thartori . Ju kemi dërguar të ardhurat e 9-të mujorit. Është bërë një analizë të ardhurash referuar planit të të ardhurave si dhe është bërë një grafik i të ardhurave të ndarë sipas zërave për vitin 2024. I referohemi grafikut të parë të ardhurat e plan faktit kemi të ardhurat e hapësirës publike, janë të ardhurat që janë pothuajse të realizuara në nivel 93% nga plani. Tatimi



mbi tokën bujqësore është realizuar 51.6 % nga plani, tatimi i ndërtesave është realizuar 57.6% nga plani, tarifa e pastrimit 60.8% nga plani. Taksat dhe tarifatat e tjera janë përmbledhur në një zë 39.2% nga plani është dhe tabela sipas të ardhurave që zë secila. Kolona e parë është plani kolona e dytë është fakti. Këto të ardhura kanë një rritje krahasuar me një vit më përpara me një përqindje rreth 18%, ndërsa realizimi i të ardhurave referuar planit është në nivel 54%. Vetëm për 9-të muaj dmth plani është vjetor ndërsa fakti është 9-mujor, tabela e dytë grafiku i dytë ka realizimin e të ardhurave sipas zërave, të ardhurën më të madhe bashkia Rrogozhinë në këtë 9-mujor e ka pasur nga tarifa e pastrimit 28.1%. Tatimi mbi tokën bujqësore zë 14% të të ardhurave vjetore të bashkisë, tatimi i ndërtesave zë 12.7% të të ardhurave totale të bashkisë ndikimi në infrastrukturë këtë vit ka qenë në nivel 11.8%, pastrimi 11.8% të të ardhurave të bashkisë. Taksa dhe tarifa të tjera kanë pasur zëra të ulëta dhe i kemi përmbledhur në 21.9% sepse ka të ardhura që mund të jenë 1%, 0.5% janë më të ulëta ndërsa për parashikimin e të ardhurave ne kemi një sistem na është dhënë nga ministria e financave dhe drejtorja e të ardhurave ka bërë parashikimin e planit të të ardhurave për tre vitet e ardhshme në sistem sipas ligjeve dhe sipas çfarë kërkon sistemi. Nëse doni ta shihni e kam printuar nga sistemi që është i plotësuar. Ndonjë pyetje?

Erind Tosku . Ku synon bashkia të ketë më shumë të ardhura ose tek këto të tjerat shikoj ...

Marsida Thartori . Është plan fakti, e dyta është shpërndarja e të ardhurave.

Erind Tosku . Hapësira publike 28, tani kemi ndikimi i infrastrukturës tatimi i ndërtesave janë me 11, 12 % si e ka një plan strategjie?

Marsida Thartori . Jo jo të ardhurat e realizuara nga toka bujqësore janë në nivel 51%. Niveli nga plani që parashikon është 51%, çfarë parashikon plani është realizimi. I ndërtesave është në nivel 57,6 % nga plani. Hapësira publike është parashikuar 100% ëshë realizuar 92 %.

Erind Tosku . Këtu flasim për gjithë bashkinë Rrogozhinë?

Marsida Thartori . Për gjithë bashkinë Rrogozhinë, hapësira publike përfshin plazhet, rërën që është një hapësirë publike. Përfshin hapësirën publike dhe në qytet për vendosjen e tavolinave, përfshin hapësirë publike vendosjen e rulot kamper, përfshin hapësirën publike nëpër pyje të vendosjes së tavolinave gjatë sezonit të verës dmth këtë përfshin hapësira publike. Ndërsa hapësira publike që është 28.1% përfshin nga të gjithë të ardhurat nëse bashkia ka një milion lekë të ardhura vjetore 28% e këtij 1 milionëshi është nga hapësira publike.



Erind Tosku . Tek planifikimi ku çalon më shumë Bashkia jonë në këtë ndarjen e të ardhurave dmth do i lejmë po në këtë lloj niveli, buxheti që do bëhet në dëgjuesën publike për Bashkinë në Dhjetor. Paketa fiskale po me këtë tarifë do rri ka ndonjë plan rritje takse dhe përfitimi nga bashkia apo jemi po me këtë dmth jemi mirë?

Enver Memolla . Erind e ke tek 11 këtë .

Marsida Thartori . Është tek pika 11, paketa fiskale është drafti i paketës.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje për drejtoreshën?

Enver Memolla . Duke marrë në krahasim këtë tre vjeçarin e fundit për të ardhurat, ka një plan masash për rritjen e të ardhurave?

Marsida Thartori . Ne presim që të rritemi në bregdet dmth synimi i të ardhurave pritet që të shtrihet nga bregdeti, kemi një zhvillim ekonomik...

Enver Memolla . Sidomos me vendimin e ri që do merret ...

Marsida Thartori . Për ristrukturimin e planit vendor të ardhurat... kemi bërë dhe një strukturë të re, ka qenë por është riorganizuar që është ngritur një sektor borxhi dhe zhvillimin ekonomik ne e shohim nga bregdeti, me planin e ri të zhvillimit të territorit presim edhe rritjen e të ardhurave.

Enver Memolla . Faleminderit.

Mukades Gixhari . Faleminderit për informacionin. Është Raport nga Administratori i Njësisë Administrative Sinaballaj mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Qershor - Gusht 2024, i cili nuk është paraqitur e shtyjmë për herën tjetër.

Enver Memolla . Mos e sill më në mbledhje këshilli raport nuk e duam.

Mukades Gixhari . Njohje dhe shqyrtim me draft Paketën Fiskale të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025. Vazhdojmë me drejtoreshën e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik, drejtori i politikave urbane.

Marsida Thartori . Tomi nuk është se kishte një takim në Tiranë me nënkryetarin njoftoi dhe dje.



Enver Memolla . Këtu mungon drejtori i shërbimeve.

Indrit Dedej . Edhe ajo është në terren.

Enver Memolla . Edhe ajo është në terren e di ku është, ka tjetër më, të sjellin përfaqësues dreqi e mori.

Mukades Gixhari . Të nderuar këshilltarë z. Hekuran ka një urgjencë që po e kërkojnë ju lutem kalojmë dy projektvendimet njëherë. Kemi projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.38 datë 27.12.2023 ‘Për miratimin e buxhetit të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024’ ”. Drejtori z. Rezart Vogli.

Enkela Ballabani . Përshëndetje! Janë të dyja kontratat kanë lidhje .

Mukades Gixhari . Kemi dhe Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar midis Bashkisë Rrogozhinë dhe ASHK-së”.

Rezart Vogli . Të flasi Enkela për marrëveshjen pastaj është projektvendimi për mua.

Mukades Gixhari . Do t’i hedhim në miratim një nga një.

Enkela Ballabani . Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe VKM nr.435 datë 26.06.2024 është për një shtesë të VKM-së nr.867, datë ..2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore” ju kërkojmë këshillit që të miratojë marrëveshjen e nënshkruar nëpërmjet bashkisë Rrogozhinë, i përfaqësuar nga kryetari i saj dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës i përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm, kohëzgjatja e kësaj marrëveshje do të jetë me afat kohor 1-vjeçar nga data e nënshkrimit. Për sa i përket marrëveshjes është një marrëveshje bashkëpunimi midis dy institucioneve që do të bashkëpunojnë bashkëveprojnë dhe kordinojnë në lidhje me : Shkëmbimin në mënyrë reciproke të informacionit lidhur me ecurinë e procesit të legalizimit në funksion të planifikimit dhe zhvillimit të territorit sipas legjislacioneve të posaçme të komunikojnë bashkërendojnë dhe kordinojnë veprimtarinë administrative nëpërmjet tyre në funksion të realizimit të kësaj marrëveshjeje. Organizimin dhe të marrin pjesë në takime të përbashkëta, të përcaktojnë plane pune dhe grafikun e prioriteteve në funksion të trajtimit me prioritet të procesit të legalizimit sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu një pikë e marrëveshjes është të caktojnë burime njerëzore të nevojshme për administrimin efikas të procesit administrativ. ASHK-ja dhe Bashkia duhet të vlerësojnë nevojën dhe mundësitë reale për legalizmin e këtij bashkëpunimi



duke përdorur të gjitha mekanizmat ligjore financiare dhe ose burime njerëzore në dispozicion për përmbylljen e procesit sipas afatit të përcaktuar në këtë marrëveshje. Marrëveshjen e keni edhe të bashkëngjitur.

Enver Memolla . Atëherë faleminderit kryetare. Marr shkas nga mbledhja e komisionit ku ishte dhe i pranishëm dhe u diskutua dhe pjesa e pikës 11 ku ishte i pranishëm dhe drejtori atë ditë. Kjo është identik si është bërë Shijaku që ka mbaruar sot legalizimi. Dhe për sa i përket zonës gjithë Bashkisë Rrogozhinë janë pothuajse 3500 dosje që janë të paprekura të pabëra për problematika e gjëra. Ajo çka kërkon marrëveshja mesa kuptova unë është që bashkia duhet të paguajë pagat me kontrata tre mujore deri në 5 punonjës ASHK-së ose kundër duhet t'i dërgojë 5 punonjës nga administrata e aparatit për të bërë punën. Mendoj që mund të jetë pak jo efikase sepse nuk ka inxhinierë bashkia për këtë punë ndoshta. Dhe kështu kjo ka mundësi të ngeli pjesë e kalimit të rrogës atyre punonjësve nga buxheti i bashkisë Rrogozhinë. Kjo është një nismë shumë e mirë kam diskutuar për këtë pjesë ka qenë dhe Indriti nga opozita dhe Vana kjo është gjë e mirë por duhet thënë dhe këto kontratat tre mujore më pas duhet që në çdo fund tre mujori të bëhet raport sa dosje janë hapur, sa janë kryer dhe problematikat. Se normalisht ka një pjesë tjetër që nuk mund të bëhet. Mund të ketë dhe shembuj ku ta di unë se si mund të bëhet ajo pjesë, procedura është e saktë sepse ka pasur bashki edhe sot që përmendet bashkia e Shijakut. Një nga gjërat që ka ecur më mirë nga të gjitha dhe pse mos e ketë bashkia jonë këtë pjesë.

Hekuran Xhani . Në mbështetje të diskutimit të z.Ver edhe unë jam dakord se ndër plagët që ka shoqëria Shqiptare është problemi i zgjidhjes së pronës dhe çështja e legalizimeve. Pra unë jam dakord t'i jepet mundësia bashkisë të japë ndihmesën e saj në procesin e legalizimit në interes të qytetarëve të bashkisë Rrogozhinë.

Mukades Gixhari . Gjë tjetër? E hedhim në votim. “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar midis Bashkisë Rrogozhinë dhe ASHK-së”. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, projektvendimi me Nr.4555.Prot datë 29.10.2024, “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar midis Bashkisë Rrogozhinë dhe ASHK-së”, dhe Relacioni shpjegues i projektvendimit me Nr.4555/1.Prot datë 29.10.2024.

Vendim nr.54. Miratohet me 11-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.4555.Prot datë 29.10.2024 “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar midis Bashkisë Rrogozhinë dhe ASHK-së”, si dhe Relacionin shpjegues të këtij projektvendimi me Nr.4555/1.Prot datë 29.10.2024.



Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën tjetër, projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.38 datë 27.12.2023 ‘Për miratimin e buxhetit të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024’ ”. Relaton drejtori i financës z. Rezart Vogli.

Rezart Vogli . Ashtu siç edhe e parashtrori drejtoresha juridike znj. Enkela .Marr shkas nga takimi që kemi pasur dhe me përfaqësues të ASHK-së ku ndër të tjera u diskutua hollësisht mënyra e funksionimit të kësaj akt marrëveshje. Unë si drejtori finance më lindi nevoja për tre kërkesa, një kërkesë për sa dosje bëhej fjalë, biles tek ai projektvendim që ju ka dërguar Visi keni dhe shkresën e tyre përcjellëse bashkëngjitur bëhet fjalë për 3500 dosje. Bëhet fjalë për 5 specialistë të cilët duhet të punësohen pranë ASHK-së, në rastin e kundërt nëse nuk është e mundur t’i ofrohet fondi për paga dhe paga e përcaktuar për secilin punonjës sipas shkresës së atyre është 103 400 lekë.

Enver Memolla . Bashkë me siguracionet.

Rezart Vogli . Bashkë, dhe qëllimi i këtij projektvendimi ky është, që bashkia e Rrogozhinës në kushtet që jemi nuk e kemi mundësinë të çojmë 5 specialistë i japim të drejtë autorizojmë ASHK-në, të punësojë 5 specialistë me qëllim që bashkisë Rrogozhinë t’i vijmë në ndihmë shqyrtimi i këtyre 3500 dosjeve. Dua të them nga ana tjetër që 3500 dosje nuk janë vetëm shqyrtim nga banorët por janë dhe një ndihmesë për buxhetin e bashkisë Rrogozhinë. Se në fund fare ato prona që legalizohen paguajnë një tarifë në bashkinë e Rrogozhinës që për momentin nuk e bëjmë dot kalkulimin se nuk e dimë se sa dosje do tatonen nga ana e tyre. Ashtu siç e tha dhe Veri ngel që muaj pas muaji në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Vendor e cila është iniciatorja e kësaj aktmarrëveshjeje ne të kërkojmë për bashkinë e Rrogozhinës, në cilën fazë jemi sa dosje janë shqyrtuar, sa qytetarë kanë përfituar dhe çfarë e ardhure i vjen Bashkisë Rrogozhinë nga kjo gjë.

Enver Memolla . Tani kjo është pak a shumë shtesa për projektvendimin tjetër dhe këtu buxheti nuk është se preket. Ajo që duhet është që ju si financë duhet të paraqisni për buxhetin që keni pasqyruar dhe pagat për tre mujorin e parë të vitit pasardhës sepse thashë tek ajo kontrata tre mujore që normalisht do kalojë prap në këshill bashkiak për të miratuar fondin çdo tre muaj. Kështu kemi rënë dakord që kjo të vazhdojë tre muaj edhe për t’i pasur në kontroll edhe për të parë ecurinë. Nëse s’do ketë kërkesa e ndërpresim...

Indrit Dedej . Edhe bashkëpunimi.

Enver Memolla . Edhe bashkëpunimi është, kështu atë pjesën tek pesë te ne pesë këtej e



zgjidhni ju mes ASHK-së dhe Bashkisë për të parë punën inxhinierike sepse ato duan inxhiniera IT apo ku ta di unë.

Rezart Vogli . Specialistë të fushës.

Enver Memolla . Po specialistë të fushës kështu që kjo për mua është edhe një gjë e mirë edhe për Bashkinë sepse taksa në infrastrukturë do ndikojë shumë edhe tek të ardhurat e buxhetit, për mua kjo është një ëgjë shumë e mirë.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim. Vota pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, projektvendimi me shkresë Nr.4530.Prot datë 28.10.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.38 datë 27.12.2023 ‘Për miratimin e buxhetit të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024’ ”.

Vendim nr.53. Miratohet me 11-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.4530.Prot datë 28.10.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.38 datë 27.12.2023 ‘Për miratimin e buxhetit të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024’ ”.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 8, ndjesë drejtoresha. Faleminderit z. Rezart për informacionin. Analizë mbi realizimin e treguesve të të ardhurave ... Është pika 10, Njohje dhe shqyrtim me draft Paketën Fiskale të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025. Drejtoresha e të ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik. Fjala për ju. Ta dëgjojmë jo nuk do lëvizim se do dëgjojmë drejtoreshën.

Marsida Thartori . Draft paketa fiskale e vitit 2025 parashikon, taksat, tarifat dhe tatimet që Bashkia Rrogozhinë do të vjeli për vitin 2025. Është e ndërtuar në kapituj, janë tarifat që janë tarifat vendore pastrim gjelbërim ndriçimi, janë taksat e pasurive të paluajtshme. Janë edhe tatimet që vilen nga strukturat qendrore të tatimeve dhe bashkisë Rrogozhinë i kalojnë përqindjet sipas ligjeve në fuqi. Është bërë në ndryshim nga vjet janë reflektuar në paketë ndryshimet ligjore.

Mukades Gixhari . Meqë e kemi në dëgjesë publike këtë pikë të rendit të ditës e shtyjmë për atëherë. Ndonjë diskutim tjetër, keni tek të ndryshmet? Meqë nuk kemi diskutime mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Faleminderit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

Mukades Gixhari . Atëherë mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Ju faleminderit për kohën.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 13 : 50^{oo} . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati rreth 01 orë ; 29 min ; 46 sek.
- Ky procesverbal mbyllet në faqen 42 (dyzet e dy).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

Sekretari i Këshillit

Ervis Shera